



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME

Numri i lëndës: 2020:917680

Datë: 28.03.2024

Numri i dokumentit: 05520522

Rev.nr.408/2023

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS – në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Zenel Leku, kryetar, Rustem Thaqi dhe Nenad Lazic, anëtar, në çështjen juridike kontestimore të paditësit - të kundërpaditurit Gj.B., nga ...,Komuna P., të cilin me autorizim e përfaqëson Bestar Kolgeci, avokat nga Prizreni, kundër të paditurit - kundërpaditësit F.B., nga ..., Komuna P., të cilin me autorizim e përfaqëson Sylejman Klinaku, avokat nga Prishtina, me objekt të padisë pasurimin pabazë dhe të kundërpadisë pagimin e borxhit, duke vendosur sipas revizionit të autorizuarit të paditurit - kundërpaditësit, i paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ac.nr.314/19 të datës 17.07.2023, në seancën e kolegjit të mbajtur më 28.03.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

Pranohet i bazuar revizioni i të autorizuarit të paditurit - kundërpaditësit F.B., nga, Komuna P., prishet aktvendimi i Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ac.nr.314/19 i datës 17.07.2023, çështja i kthehet gjykatës së shkallës së dytë në rishqyrtim dhe vendosje.

A r s y e t i m

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prizren - Departamenti i Përgjithshëm,C.nr.287/18 të datës 01.08.2018, në pikën I të dispozitivit është aprovuar si e bazuar kërkesëpadia e paditësit - të kundërpaditurit Gj.B., nga ..., Komuna P., dhe e ka obliguar të paditurin - kundërpaditësin

F.B., nga ..., Komuna P., që t'ia kthejë paditësit, në emër të pasurimit pa bazë shumën prej 11,500 CHF për automjetin "...", 4,000 CHF për rregullimin e verandës dhe 1,500.00 € për qiranë e papaguar për muajt XI dhe XII - 2017 dhe muajin e I - 2018, me kamatë ligjore prej 8%, e cila do të llogaritet nga dita e parashtrimit të padisë deri në pagesën definitive, të gjitha në afat prej 15 ditëve, nën kërcënim të ekzekutimit të dhunshëm. Në pikën II të dispozitivit është refuzuar si e pabazuar kërkesa nga kundërpadia e të paditurit - kundërpaditësit F.B., me të cilën ka kërkuar që të obligohet paditësi-i kundërpadituri, që t'ia paguajë shumën prej 17,127 €, ose për mirëmbajtjen e shtëpisë shumën prej 21,600 € dhe për pagesën e faturave shumën prej 12,527 €, gjithsej shumën prej 34,127 €, me kamatë ligjore prej 8%, e cila do të llogaritet nga dita e parashtrimit të kundërpadisë deri në pagesën definitive, të gjitha në afat prej 15 ditëve, nën kërcënim të ekzekutimit të dhunshëm. Në pikën III të dispozitivit, është refuzuar propozimi për caktimin e masës së përkohshme të sigurisë dhe në pikën IV të dispozitivit, është obliguar i padituri F.B., që paditësit Gj.B., t'ia paguajë shpenzimet e procedurës në shumë prej 820 €, në afat prej 15 ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Gjykata e Apelit të Kosovës, duke vendosur sipas ankesës të autorizuarit të paditurit - kundërpaditësit, me aktvendimin Ac.nr.314/19 të datës 17.07.2023, ka hedhë poshtë të palejueshme (paafatshme) ankesën e të paditurit – kundërpaditësit F.B., nga B., Komuna P., e parashtruar kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prizren, C.nr.287/18 të datës 01.08.2018.

Kundër aktvendimit të gjykatës së shkallës së dytë i autorizuari i të paditurit - kundërpaditësit në afat ligjor ka paraqitur revizion, për shkak të shkeljes thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që Gjykata Supreme e Kosovës të pranoj revizionin e të paditurit, ashtu që të ndryshoj aktvendimin e Gjykatës së Apelit dhe aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prizren, apo të aprovoj kërkesëpadinë e të paditurit si të bazuar me ligj.

Pala e paditëse e kundërpaditur nuk ka paraqitur përgjigje në revizionin e të autorizuarit të paditurit - kundërpaditësit.

Gjykata Supreme e Kosovës, në procedurën e vendosjes sipas revizionit në kuptim të dispozitave të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK) nga neni 211, 212 dhe 215 gjeti se:

Revizioni i të autorizuarit të paditurit - kundërpaditësit është i themeltë.

Nga shkresat e lëndës rezulton se Gjykata e Apelit të Kosovës në procedurën e vendosjes sipas ankesës së të paditurit - kundërpaditësit F.B., e ka hedhë ankesën e të paditurit si të palejueshme (paafatshme), për shkak të lëshimit të afatit në paraqitjen e ankesës, duke vendosur si në dispozitiv të aktvendimit të atakuar.

Vendosjen në këtë mënyrë Gjykata e Apelit e ka mbështetur në dispozitat e nenit 196 dhe 186.2 të LPK-së, duke arsyetuar me atë se ankesa e paraqitur nga i padituri-kundërpaditësi është e paafatshme, pasi që me shikimin në fletë-kthesën për dorëzim personal, vërtetoi faktin se i padituri aktgjykimin e atakuar të Gjykatës Themelore në Prizren, C.nr.287/18 të datës 01.08.2018, e ka pranuar më datë 12.11.2018, ndërsa ankesa ndaj këtij aktgjykimi është dorëzuar në gjykatë më datë 31.12.2018, e cila shihet nga vula e pranimit të gjykatës, e vendosur në ankesë. Është vlerësu se në shkresat e lëndës nuk gjendet asnjë shkresë tjetër, përmes së cilës do të konfirmohej se ankesa ndaj këtij aktvendimi është dorëzuar edhe në ndonjë mënyrë tjetër siç parashihet në nenin 103 të LPK-së. Pasi që afati për ankesë kundër aktgjykimit apo aktvendimit të dhënë nga gjykata e shkallës së parë sipas dispozitës së nenit 176 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPP), është (15) ditë nga dita e pranimit të vendimit (*i cili afat i është dhënë në udhëzimin juridik të aktgjykimit të atakuar*), atëherë rezulton që ankesa është dorëzuar pas skadimit të afatit ligjor prej (15) ditësh. Kjo për faktin se në rastin konkret afati ka filluar të llogaritet nga data 13.12.2018 (*dita e parë pas ditës së pranimit të aktgjykimit-ditë e mërkurë*), ndërsa kur llogariten 15 ditë, atëherë dita e fundit për parashtrimin e ankesës ka qenë data 27.12.2018-ditë pune, ndërsa i padituri, përkatësisht i autorizuari i tij ankesën e ka paraqitur me datë 31.12.2018, që rezulton se ankesa është paraqitur në ditën e nëntëmbëdhjetë (me vonesë prej 4 dite). Nga këto arsye e në mbështetje të neneve 186.2, 195.1 pika a), e lidhur me nenin 196 të LPK-së, është vendosur si në dispozitiv të aktvendimit të atakuar me revizion.

Gjykata Supreme e Kosovës, duke u nisur nga një gjendje e tillë e çështjes pranon revizionin e të paditurit - kundërpaditësit si të bazuar, pasi që nuk mund të pranoj si të ligjshëm qëndrimin e gjykatës së shkallës së dytë, kjo për shkak se aktvendimi i gjykatës së shkallës së dytë është marrë në kundërshtim me dispozitat nga nenet 186.2, 195.1 pika a) 126 dhe 127 të LPK-së.

Gjykata e Apelit ka trajtuar ankesën e të paditurit-kundërpaditësit si të pasafatshme duke marrë për bazë datën 31.12.2018, që njëherit është datë nga vula e pranimit të ankesës në gjykatë, mirëpo pala e paditur-kundërpaditësi vendimin e shkallës së dytë e ka atakuar me revizion duke vlerësuar se ankesa është e afatshme, pasi që ajo është paraqitur brenda afatit ligjor, përkatësisht

është paraqitë më datë 27.12.2018 dhe atë përmes postës me letër rekomand (me numër serik, të datës 27.12.2018).

Gjykata Supreme për të vërtetuar çështjen e afatshmërisë së ankesë, përkatësisht pretendimin se ankesa është paraqitur përmes postës me letër rekomand, me kërkesën e datës 26 tetor 2023 i është drejtuar N. P. Q, P e K., Sh.a, që të sqaroj se çfarë lloj dokumenti është dorëzuar në të njëjtën datë në postë, pasi që tek emërtimi figuron vetëm “letrat”, ndërsa përgjigja e tyre e datës 09.11.2023 ka qenë se posta nuk mund ta dij përmbajtjen e dërgesës pasi ajo është në zarf.

Kjo gjykatë me shkresën e datës 22 nëntor 2023, ka kërkuar nga Gjykata Themelore Prizren - Zyra për Menaxhimin e Lëndëve, sqarim dhe informata të detajuara lidhur me ankesën në fjalë, se e njëjta a është dorëzuar përmes postës apo drejtpërdrejtë në gjykatë, me çfarë date është dërguar ankesa e lartcekur në postë - pranuar në gjykatë dhe nëse është dorëzuar me postë, në shkresa të lëndës të bashkëngjitet zarfi i dorëzuar në postë, ose nëse është dorëzuar fizikisht të jepen informata të sakta se kur është dorëzuar - pranuar në gjykatë. Gjykata Themelore në Prizren me njoftimin e datës 19.12.2023, ka theksuar se pas konsultimit me referentin e pranimit, shikimit në librin e evidencave dhe shikimit në shkresa të lëndës, kemi vërtetuar se ankesa C.nr.287/18, në Gjykatën Themelore në Prizren është regjistruar në librin e pranimit me numër, më datë 31.12.2018 dhe se në librin e pranimit nuk është cekur se ankesa ka ardhur me postë, e as numri rekomandues siç duhet të ceket.

Gjykata Supreme përsëri me emailin e datës 20.12.2023 ka kërkuar sqarim nga Gjykata Themelore në Prizren në lidhje me datën dhe mënyrën e pranimit të ankesës në gjykatë. Udhëheqësi i Zyrës për Menaxhimin e Lëndëve me emailin e të njëjtës datë ka kërkuar që lënda të kthehet përsëri në Gjykatën Themelore në Prizren, për të sqaruar mënyrën e pranimit të lëndës në gjykatë. Gjykata Themelore në Prizren me njoftimin e datës 18.03.2024, ka theksuar se pas konsultimit me referentin e pranimit, shikimit në librin e evidencave dhe shikimit në shkresa të lëndës, kemi vërejtur se ankesa C.nr.287/18, për të cilën është kërkuar njoftimi, në Gjykatën Themelore në Prizren është regjistruar në librin e pranimit me numër, më datë 31.12.2018. Pastaj është thënë se duke e ditur faktin se ankesa e dorëzuar fizikisht nuk pranohet pa taksë, po ashtu për ankesë palës i është dërguar edhe vërejtja për pagesën e taksës, atëherë kemi të bëjmë me ankesë e cila ka ardhur me postë. Në anën tjetër në librin e pranimit nuk është cekur se ankesa ka ardhur me postë, e as numri rekomandues ashtu siç duhet të ceket dhe as zarfi i ankesës.

Në rrethana të tilla kjo gjykatë vlerëson se ankesa e palës së paditur - kundërpaditësit duhet të trajtohet si e afatshme dhe Gjykata e Apelit të njëjtën ta trajtoj sipas kompetencës së saj, ngase në mungesë të dëshmive të paraqitura nga gjykata e shkallës së parë për mënyrën se si pala e ka ushtruar mjetin juridik, kjo në asnjë mënyrë nuk mund të interpretohet në dëm të palës në procedurë. E drejta në mjet juridik është e garantuar edhe me Kushtetutën e Republikës së Kosovës (neni 32 i Kushtetutës), andaj në këto rrethana kur gjykata nuk është në gjendje të dëshmojë mënyrën se si pala e ka dorëzuar ankesën dhe çështjen e afatshmërisë, çdo vendim tjetër rreth afatshmërisë së ankesës do të konsiderohej si shkelje e të drejtës së palës për qasje në gjykatë dhe drejtësi, që njëherit është në kundërshtim me garancitë e përcaktuara me paragrafin 1 të nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës, në lidhje me paragrafin 1 të nenit 6 [E drejta për një proces të rregullt] të KEDNJ-së.

Na këto arsye çështja është kthyer në rivendosje në Gjykatën e Apelit, në mënyrë që ankesa të trajtohet e afatshme dhe të shqyrtohet konform dispozitave të Ligjit të Procedurës Kontestimore.

Nga arsyet e paraqitura më lart e në pajtim me dispozitën e neni 224 paragrafi 2 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS NË PRISHTINË

Rev.nr.408/2023, datë 28.03.2024

Kryetari i Kolegjit- Gjyqtari

Zenel Leku